

E pyeta një ditë Mariana Andrevnën se si përkthehej në gjuhën moldave “прожектор”\*. “Një lloj llambe”, ishte përgjigjja e saj, si zakonisht, gjeniale. Nuk më mbante vendi. Çdo mbrëmje shikoja bashkë me Tamara Pavlovnën *Прожектор перестройки*\*\*, emisionin më të famshëm të atyre kohëve, dhe nuk e kuptoja se çfarë do të thoshte “прожектор”. Pra, qenka një lloj llambe. Në shkollë, mendimet për perestrojkën ishin të ndryshme. Fëmijët që vinin nga familje me njerëz të zgjuar thoshin se perestrojka ishte e mirë. Liri dhe gjëra të këtilla. Ndryshe nga ata, fëmijët e familjeve ku idetë ishin në vend të dytë, të tretë ose të njëzet e katërt - si tek unë dhe te Tamara Pavlovna - thoshin se bota po rrokullisej teposhtë luginës. Sikur të ishte e mundur që diçka të mund të rrokullisej buzë kodrës. Koha e tregoi se patën të drejtë edhe njëra palë, edhe tjetra.

Pas sa kujtimesh bëhet njeriu i alkoolizuar? Pas sa tradhtish nxihet zemra e një fëmije? Nuk duhej të isha bërë doktoreshë, nuk duhej. Disa njerëz profesioni i helmon dhe pas Tamarës sime, do të kish qenë e drejtë që të mos u afrohesha më fëmijëve të të tjerëve. I shoh kur lindin - të butë dhe të pafuqishëm - dhe mendoj që të paktën ata do të jenë të lumtur. Me nënat, me baballarët. Me para. Më pas i shoh se si i ngulin nofullat tek ato që i kanë lindur dhe thëthijnë si qenushë të vegjël. Çfarë është dhimbja e një njeriu tjetër përpara urisë sate?! Mizori. Mizoria është tashmë aty, tek ata, duke u dridhur si një lule e kuqe.

---

\*Rusisht - Projektor.

\*\*Rusisht - Projektorin e perestrojkës.

Mizoria rritet brenda një njeriu më shpejt se thonjtë, se flokët, se dhëmbët.

Ajo grua që lindi një djalë të vdekur - unë gjithsesi shkova tek ajo - më tha se, sidoqoftë, e quan veten nënë. Se vdekja nuk bëri gjë tjetër veçse e shtrëngoi t'i kapërcente disa etapa. *Të gjithë aty përfundojmë - edhe të gjallët, edhe të vdekurit, edhe të tjerët ndërmjet.* Fjalët e saj më zunë pritë dhe ende më kumbojnë në kokë. Vazhdoj të mendoj për to, i përbluaj, dua të jenë të vërteta edhe për mua. *Edhe të tjerët ndërmjet.* Vdekja! Vdekja, gjithsesi, bën atë që do. Por çfarë ndodh kur jeta i kapërcen disa etapa? Kur shikon që ende ke mish dhe fuqi, ndërsa ajo, jeta, të dërgon në fund të radhës dhe të shikon sikur je gati i vdekur? Unë jam ndërmjet, Tamara është ndërmjet. Gjithë jeta ime ka qenë ndërmjet. Të paktën dy etapa pas do të doja. Të paktën pa këtë mashtrim të madh që duhej të ishte dashuria.

## 86

Por çfarë do të thotë në të vërtetë “гласность”?

Të shash në trolejbus.

Të spiunosh te milicët se cili fqinj shet alkool.

T'i dërgosh rusët në shtëpi.

Kjo me rusët dëgjohej shpesh, shumë shpesh për një qytet të vogël, ku gjykata ishte legjion. Gjithnjë e më shumë moldavë thoshin hapur se kanë gjuhën e tyre, me theksin te fjala “jonë”. Gjuha jonë, gjuha jonë - nga televizori, nga radioja, nga goja. Për disa rusë, këto ishin fjalët e para moldavisht që u hynë në kokë. Sikur të ishin të vetmet. “Gjuha jonëëë”, thërriste Shuroçika nga ballkoni, me

---

\*Rusisht - Gllasnost: reformë politike e prezantuar nga Mihail Gorbaçovi, që synonte nxitjen e demokratizimit në Bashkimin Sovjetik.

neveri, sikur të ishte italiane, duke treguar ndonjë histori të stisur aty për aty. Shuroçika dinte si t'i përshtaste historitë e saj.

Për mua, që isha rritur në jetimore, dëshira, por sidomos gëzimi për të quajtur diçka "tonën", ishte i huaj. Unë thosha "imja" në të gjitha gjuhët: edhe një mështekne, edhe diellit, edhe Leninit. Gjithçka mbi të cilën vija dorën bëhej imja. Një mbrëmje, nga budallallëku, e pyeta Tamara Pavlovnën se ku ishte shtëpia e rusëve, por hëngra një shpullë të dhimbshme në fytyrë. Përgjigjja e saj për të gjitha pyetjet e mia të gabuara. Ma shpjegoi Marina të nesërmen: stacioni i trenit, stacioni i trenit ishte shtëpia. E ndieja, e shikoja se diçka kishte ndryshuar.

Në oborr, fëmijët e moldavëve nuk lejonin më që të quheshin "mëmëligëngrënës" nga fëmijët e rusëve ose u përgjigjeshin flakë për flakë duke i quajtur "derra". Pas mësimit, djemtë e shkollës ruse të luginës vinin që të rriheshin me djemtë tanë. Tanët dukeshin se i mundnin më shpesh. Me vajzat ndodhte ndryshe. Ruset ishin konsideruar gjithmonë më të bukura dhe më të zgjuara sesa moldavet dhe kështu kishte mbetur. Ishte shumë e nevojshme një gozhdë që të na qetësonte të gjithëve.

Raja dukej e zemëruar, por nuk më tha të largohesha. "Ama, kohë për të ardhur gjete dhe ti", më thirri pas derës dhe iku me nxitim për në kuzhinë. E ndoqa, e ofenduar. Doja të dija se nga vinte era e keqe. Mbi plitë, një kazan alumini, në të cilin gjatë verës e kisha parë që shpëlante frutat për të bërë reçel. Era më dukej e njohur, megjithëse nuk kishte sesi të ishte ushqim. Iu afrova dhe pashë një shkumë të kuqërremtë, gati për t'u derdhur nga skajet e kazanit. Raja vuri kapakun dhe era u largua disi. "Çfarë është kjo?" e pyeta me dorën mbi buzë. "Pse, s'të zë gjumi po s'ta thashë?" m'u sul ajo.

Kisha ardhur, në fakt, për një punë.

Duhej të bëja një suxhuk me çokollatë - një nga idiotësitë që u kërkoheshin vajzave nga klasa e katërt. Kaq mbaj mend nga orët e *përgatitjes për jetën*: suxhukun me çokollatë dhe punimin kryq. Me fjalë të tjera, për jetën dola e përgatitur më së miri nga shkolla. Për pjesën tjetër nuk po flas më mirë. Askush nuk më përgatiti për dhunën. Askush nuk më përgatiti për tradhtinë. Të lajë, të hajë, të flejë: këto duhej të dinte një grua. Askush nuk më tha që do të vijë një ditë kur burri im - një nga djemtë që në të njëjtën orë mësimi bënëin gdhendje të admirueshme në dërrasë - do t'i bënte naftën ushqimit dhe pastërtisë sime dhe do të ikte. Madje as te ndonjë grua tjetër, as me ndonjë qëllim të saktë. Thjesht fare, do të ikte. Pak a shumë kështu ishte përgatitja jonë për jetën. Të rrahin - bën një suxhuk me çokollatë. Sjell në jetë një fëmijë të sëmurë - qep një shami me kryqe.

Është e vërtetë, jam e keqe. Shaj dhe pi. Bëj edhe gjëra të tjera. Nuk ka xixëllonja magjike në gropën time të errët. Nuk bëra suxhuk as atë ditë dhe as ndonjë ditë tjetër. Raja shpëlante në kazan pëlhurat që vinte midis këmbëve, ashtu siç duhej të bënin të gjitha femrat një herë në muaj. Kur mora vesh se çfarë kishte mbi plitë dhe dallova erën e gjakut të ndenjtur, dola jashtë dhe volla nëpër shkallë gjithë ç'kisha ngrënë.

*Rrush* - *pasuria më e madhe e tokës!* shkruhej mbi letrën e ngjitur në xhamin e përparmë të Ikarusit që do të na çonte në një fermë bujqësore në periferi. Disa fëmijëve u kishin ardhur prindërit që t'i përcillnin. Për t'u sjellë vezë të ziera dhe qofte që vinin erë hudhre, të cilat konsideroheshin si ushqim për rrugë nga ata të qytetit. Por edhe për të këmbyer nja dy fjalë me mësuesit shoqërues. "Ju lutem,

Natashika ka hequr apendicitin." Ose: "Genadzia ftohet shumë shpejt, nëse është e mundur, ta bëjë me doreza dhe shall atë punë." Tamara Pavlovna, kur mori vesh se do të ikja me shkollën për punë, më pyeti nëse do të paguhesha. I thashë që nuk e dija. "Delja thith kur është qengji, budallai gjithë jetën", foli ajo me përçmim kur më dha dorën. Gëzimi i shoqeve dhe shokëve të klasës nuk kishte kufi. Gëzohesha edhe unë me sa ma merrte mendja. Çfarë kisha parë deri atëherë? Sa isha në jetimore, nuk dola gjëkund. Bota e jetimëve mbaron para portës dhe pas mensës.

Nga xhami i madh i autobusit shikoja një tjetër lloj jete. Në vend të pallateve dhe ballkoneve, shtëpi me porta dhe qen të lidhur me zinxhirë. Në vend të rrugëve të gjera, rrugë të ngushta, pata. Karroca dhe kamionë. Asnjë semafor, lopë. Shkolla, управления\*, kisha me "k" të vogël. Gratë me shami në kokë. Burrat shumë të gëzuar, fëmijët e tyre na përshëndesnin me dorë.

E gjelbër, e purpurt, e verdhë: hardhia nuk kishte fund. Vargje shumëngjyrëshe prej mëndafshi - dhe ato që kishin mbetur nga fustanet e grave gjatë vitit - shkëlqenin nëpër rrush si mbetjet e verës. Një bukuri e jashtëzakonshme do të kisha thënë nëse do ta dija këtë fjalë atëherë. Por nuk e dija. U mbusha thellë me ajër në kraharor dhe më kapi veshi Mariana Andrevnën duke folur. "Po shikojmë vreshtat, fëmijë, thesarin e paraardhësve, gëzimin e duarve, këngën e vendit." E kështu me radhë. U shkëputa nga klasa dhe vrapova me krahët hapur deri në mesin e një rreshti. Nuk e besoja dot se e gjithë ajo bukuri ndodhej jashtë Qytetit. Pas kodrës doli dielli dhe, e prekur nga drita e mëngjesit, hardhia u përflak. U shtriva mes trungjeve dhe fillova të haja rrush, duke gëlltitur kokrrat me gjithë fara. Kishin aromë bari dhe borziloku, lumturie. Doja të vrapoja, të fshihesha, të qëndroja aty. Të paktën për një ditë, të paktën deri në darkë.

---

\*Rusisht - Drejtoria.

*Zbulo: gjyshërit vdesin në të njëjtën kohë me prindërit e tyre?*

*Pse jetimët nuk përfundojnë te prindërit e prindërve të tyre, por te Tamara Pavlovnat?*

*Zbulo: nga i merr Polkovniku farat magjike?*

89

Në të vërtetë, shifrat të gëzonin. Alkoolizimi kishte rënë, ndërsa të tjerat ishin rritur. Tamara Pavlovna nuk shikonte më fare televizor - i dhembte koka nga lajmet. Sidomos pasi kishte mbetur pa punë, pikërisht për shkak të asaj nevoje. Shishet kishin përfunduar në plehra. Qendra jonë e grumbullimit u bashkua me një tjetër më të vogël dhe mbledhëse shishesh mbeti një grua e re, e cila fliste edhe moldavisht. Mendova se kjo do ta shkatërronte, por gabova. Qau nja dy ditë dhe filloi të ndihmonte Rajën në tregtinë e paligjshme. U ecte goxha mirë. Mbante sërish çanta gjithë ditën, vetëm se jo shishe bosh, por me verë dhe camoron\*. Roja, Vanja, i cili e dinte se me çfarë merreshin ato, merrte para për këtë. I kishin shpatullat të ngrohta.

Po në atë kohë filloi të shkonte më shpesh edhe në Odesë. Kur, pas disa vjetësh, mora vesh se shiste në të zezë ilaçe të rralla, të cilat ia jepte kontrabandë Mihaili, nuk u habita shumë. Ikte një herë në dy javë dhe nuk më linte më me asnjë natën. “Kur isha sa ti, e rrisja e vetme Mishën”, më thoshte sa herë që dilte nga dera me çantën e zezë. Gënjente, sigurisht. Dukej që fshihte diçka, por unë as që doja t’ia dija. Madje isha e gëzuar që më linte vetëm. Shikoja televizor deri vonë, dendesha me sallam pa bukë dhe pija kavanoza të tërë me lëng mështekne. Kisha vjedhur shumë para dhe i mbaja të fshehura në bodrum, pranë tubit. Mund të blija çfarë të doja. Se përse vidhja, nuk

---

\* Rusisht - Raki artizanale.

e di. Jo nga varfëria, jo nga uria. Para më jepte gjithmonë. Më së shumti vidhja nga bindja se më takonte më shumë ose, të paktën, barabar me të. Si mund ta dënoja ndryshe, përveçse duke e varfëruar?!

90

Në shkollë isha një nga nxënëset e dalluara. Pengesë kisha vetëm gjuhën. Edhe Mariana Andrevna, e cila ishte budallaqë, habitej sesi e kisha të vështirë një disiplinë aq të lehtë. Nga inati, ndoshta, kërkoja gjithnjë e më shpesh në televizor emisione në gjuhën moldave. Tamara Pavlovna shtrembëroi hundën nja dy herë, por i thashë se ishte “për t’u praktikuar”. Dhe që të mos na duhej t’i çonim mësueses dhurata, ashtu siç bënin fëmijët e tjerë. Kjo i pëlqeu.

Diskutimet për “pushtuesit” - siç quheshin, kohët e fundit, rusët - vazhdonin. Nuk dija anën e kujt të mbaja. Shkolla ime ishte moldave, por mua më pëlqente më shumë rusishtja. Flisja rusisht në oborr, në dyqan, në qytet. Domethënë, kudo. Greta, ajo që shkruante gjithmonë me shkumës, kishte filluar një tjetër mashtrim. “Gjuha jonë është gjuha rumune, jo moldave”, e dëgjoja duke folur korridoreve. Fëmijët e dëgjonin gojëhapur. Një ditë, shkova ta dëgjoja edhe unë, por nuk kuptova ndonjë gjë të madhe. Për shembull, ajo thoshte, në të kaluarën, Moldavia ka qenë e ngjitur - kështu tha! - me Rumaninë. “Me çfarë ka qenë e ngjitur?” e pyeta unë dhe ajo vari turinjtë. Pastaj thoshte se rusët i vranë të gjithë moldavët e zgjuar, duke lënë gjallë vetëm budallenjtë. Këtu nuk dija ç’ të thosha. Dhe, në fund, na pëshpëriti se i ati e kishte mësuar të lexonte në latinisht.

Është e vërtetë se Greta fliste më bukur sesa Mariana Andrevna dhe këtë nuk ishte e vështirë ta kuptoje. Mariana Andrevna fliste si asfaltshtruese ku dikush kishte futur një patate në tubin e shkarkimit. Dhe po atë erë vinte. Sa për të tjerat, nuk i besoja asnjë fjale që kisha dëgjuar nga Greta.